



**Titulli i projektit**

Ngritja e një qendre shërbimesh me një ndalesë – Faza II  
“Infrastruktura dhe Funksionimi”

**Tipi i projektit**

Zhvillim ekonomik/Kohezion Social

**Vendndodhja  
e projektit**

Rrashbull

**Buxheti i paravlerësuar**

52,000 Euro

**Përshkrimi dhe analiza  
e problemit/eve**

Njësia administrative Rashbull ka numrin më të lartë të njësive ekonomike të regjistruara në territorin e saj (pas Durrësit). Në këtë situatë, është evidentuar nevoja e ngritjes së një infrastrukture mbështetëse të nevojshme për shërbimet ndaj biznesit, konkretisht një qendre shërbimesh me një ndalesë për biznesin. Si fillim mund të ofroreshin të gjitha shërbimet e nevojshme për biznesin që ofrohen nga pushteti vendor (mundësisht dhe nga ai qendror).

Në fazën e dytë mund të vendoseshin dhe biznese private, si shërbime kontabiliteti, logjistike, ligjore etj.. Kjo do të përmirësonte dhe plotësonte paketën e shërbimeve për bizneset aktive në Rashbull.

**Qëllimi/et specifik  
të projektit**

Qëllimi i projektit është përmirësimi i nivelit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve për biznesin. Kjo pason fazën e parë që është vlerësimi (shiko fishën 10).

**Rezultatet e pritshme  
dhe treguesit**

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- (a) rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara bizneseve dhe përmirësimin e nivelit të tyre;
  - b) rritjen e efikasitetit dhe të ndikimit të këtyre bizneseve në rajon.
- Krijimi i shërbimeve mbështetëse (bankare, ligjore, etj.) në qendrën me një ndalesë do të ndikojë direkt në përmirësimin e nivelit të shërbimeve që do t'u ofrohen bizneseve aktive në Rashbull dhe 6652 banorëve të kësaj zone.

# PROJEKTI 11



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

Kohë e përafërt për zbatimin e projektit është 12 muaj, me zgjatje disavjeleare.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë:

- (a) identifikimin dhe përgatitjen e zyrave;
- (b) ngritjen e zonës së shërbimeve mbështetëse (ligjore, financiare, etj.) për qendrën me një ndalesë,
- (c) punësimin e ekspertëve;
- (d) ofrimin e shërbimeve

## Maturimi i projektit

Pas pesë viteve të para, qendra me një ndalesë mund të krijojë të ardhura vetjake nga shitja e shërbimeve tek kompanitë private.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burim i mundshëm financimi është mbështetja me donacione gjatë 5 viteve të para dhe pastaj gradualisht fondet e bizneseve private.

Partnerët e mundshëm në zbatimin e këtij projekti përfshijnë bizneset private, Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë, etj..

## Kostot e projektit

Kostot e projektit vlerësohen të jenë rreth 52,000 Euro për investimet në zyra, pajisje dhe burime njerëzore për një vit.